

Përkrahje për kandidatët

Pyetjet më të shpeshta

**KOSOVË: Fuqizimi i qeverisjes së mirë,
transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve
qeveritare - FCO CSSF**

Version 1.0

Pyetjet më të shpeshta

Pyetje: *Nuk mund të aplikoj pasi që nuk e kam përkrahjen e nevojshme politike?*
Përgjigje: Përzgjedhja e drejtë ka të bëjë me tërheqjen e aplikantëve më të mirë nga e tërë Kosova. Ka të bëjë edhe me zhvillimin e një procesi për ta gjetur personin më të mirë të mundshëm për një pozitë. Kjo është në interesin më të mirë të Kosovës, institucionit rekrutues dhe të Qeverisë. Po, ka shembuj kur ka emërimet politike, megjithatë, emërimet duhet të bëhen në bazë të meritës dhe ekziston legjislacion që e përkrahë këtë. Emërimi i kandidatëve më të mirë është në interesin e përgjithshëm të Kosovës - ju lutemi aplikoni!

Pyetje: *Një kandidat i preferuar nga politika e ka marrë pozitën - kjo tregon që proceset janë të padrejta?*

Përgjigje: Ndërhyrja politike është vetëm njëra nga shpjegimet për këtë. Shpjegimet tjera janë që ky kandidat kishte performancën më të lartë dhe ishte më i përshtatshmi edhe pse ishte i preferuar nga politika. Do të ishte pashtu gabim nëse nuk emërohet kandidati më i mirë vetëm pse personi është i preferuar nga politika.

Pyetje: *Kam qenë kandidat me më së shumti përvojë nga sektori për këtë pozitë - si mund të emërohej dikush tjetër para meje?*

Përgjigje: Përvoja e madhe në një profesion të caktuar, fushë, sektor, industri apo institucion mund të jetë e dobishme - megjithatë, edhe faktorë të tjerë janë të rëndësishëm. Për shembull, zgjedhja e dikujt që e ka llojin e duhur të përvojës në drejtimin e një organizate në nivel strategjik dhe ka histori të regjistruar të trajtimit të çështjeve që janë të ngjashme me ato me të cilat ballafaqohet institucioni ku ky kandidat ka aplikuar mund të jetë gjithashtu e rëndësishme.

Pyetje: *A nuk është detyrë e Komisionit që t'i mbledhë dëshmitë e duhura, e jo e imja si aplikant apo kandidat*

Përgjigje: Vetëm deri në një masë, ata kërkojnë dëshmi që të kenë mundësi për ta bërë emërimin më të mirë. Megjithatë, përgjegjësia kryesore mbetet te kandidati që të paraqet dëshmi dhe që këtë ta bëjë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe bindëse.

Pyetje: *Kam paraqitur aplikacion dhe jam eliminuar për mungesë dokumentesh - sigurisht që kjo është e padrejtë?*

Përgjigje: Është përgjegjësi e kandidatit që të sjellë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet deri në datën e fundit për aplikim.

Pyetje: *Jam i pakënaqur rreth një procesi, a duhet të ankojem?*

Përgjigje: Së pari mendoni pse jeni të pakënaqur. Nëse arsyeja është se nuk keni qenë të suksesshëm atëherë vetëm kjo nuk përbën bazë për ankesë. Nëse megjithatë, ka pasur diçka të papërshtatshme apo jashtë procedurës/ligjit atëherë duhet të mendoni për ankesë. Një proces efektiv i ankesës është thelbësor për çdo proces të shëndoshë rekrutimi. Nganjëherë gjërat bëhen gabimisht - kjo zakonisht nuk bëhet me qëllim nga Komisioni, por gabimet

ndodhin. Nëse mendoni se diçka është bërë qëllimisht, atëherë paraqitja e ankesës është shumë e rëndësishme për ta parandaluar përsëritjen e kësaj në të ardhmen. Ankesat nuk duhet të shihen si negative, ato janë mundësi për të siguruar llogaridhënie dhe mësim.

Pyetje: *Çka nëse nuk më kujtohet ndonjë shembull për ndonjë pyetje të*

kompetencës?

Përgjigje: Dëgjojeni pyetjen me kujdes. Mos keni frikë që të ndani pak kohë për të menduar dhe zgjedhur shembullin më të mirë që i përshtatet pyetjes para se të filloni të flisni. Nëse jeni përgatitur mirë, do të duhej të kishit disa shembuj për t'i përdorur gjatë intervistës. Lejoni kohë vetës për të menduar pak për përvojat tuaja më të fundit në punë. Mendoni për çfarëdo sfide që keni pasur apo situata kur keni qenë të kënaqur me suksesin tuaj, merrni shembuj rastet kur keni marrë rol udhëheqës dhe keni arritur një rezultat të konsiderueshëm apo ndonjë rezultat ndryshe. Megjithatë, nëse vërtetë nuk ju kujtohet ndonjë rast i tillë, përshkruani, se si do ta menaxhonit një detyrë apo situatë të ngjashme nëse paraqitet në të ardhmen.